

VENDIM
Nr.1633, datë 17.12.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.279, DATË 5.6.1995 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E SASISË SË UJIT PËR FUNIZIMIN ME UJË TË
QYTETIT TË TIRANËS DHE PËR UJITJEN E TOKAVE BUJQËSORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronjat “a” e “b” të paragrafit të parë të vendimit nr.279, datë 5.6.1995 të Këshillit të Ministrave, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) Për nevoja të furnizimit me ujë nga ujësjellës-kanalizime, sh.a., Tiranë për qytetin e Tiranës e të rrethinave pranë tij, të përdoret sasia e ujit prej 82 (tetëdhjetë e dy) milionë m³ ujë në vit.

b) Për ujitjen e tokave bujqësore të përdoret sasia e ujit 5 (pesë) milionë m³ ujë në vit.”.

2. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha